



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.06.2021, merr këtë

## V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, pasuri shoqërore, Kuvendi Komunal Prishtinë dhe PSH, rrugë publike të pakategorizuar, me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahman Haradinit dhe Shaban Konxhelit.
- II.
  1. Prona e paluajtshme komunale, pasuri shoqërore, Kuvendi Komunal Prishtinë dhe PSH, rrugë publike e pakategorizuar, që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesa e parcelës kadastrale nr. 466-1, me sip.57349m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë nr. P-71914032-00466-1, 459-0, me sip.4865m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë nr. P-71914032-00459-0 dhe 616-0, me sip.4318m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë nr. P-71914032-00616-0, me sipërfaqe totale prej. 66532m<sup>2</sup>, Zona kadastrale Zllatar, Prishtinë, me destinim ndërtim dhe shkollë, kopsht dhe gjelbërim, sipas Planit rregullues "Prishtina e Re - Lindje", i miratuar me Vendimin nr. 01-350/05-159745/19, dt.08.07.2019.
  2. Kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, janë parcelat kadastrale nr. 603-2, sip.7310m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914032-00603-2, 603-3, sip.5720m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914032-00603-3, 603-4, sip.5223m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914032-00603-4, 603-5, sip.5222m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914032-00603-5, 603-6, sip.5222m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914032-00603-6, 574-2, sip.14240m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914032-00574-2, 578-2, sip.50914m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914032-00578-2, 578-4, sip.3426m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914032-00578-4, Zona kadastrale Zllatar Prishtinë, në pronësi të Rrahman Haradinit, dhe 574-3, sip.32640m<sup>2</sup>, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914032-00574-3, Zona kadastrale Zllatar Prishtinë, në pronësi të Rrahman Haradinit dhe Shaban Konxheli, me sipërfaqe totale prej: 129917 m<sup>2</sup>, me destinim gjelbërim, të planifikuar sipas Planit Rregullues, sipas Planit Zhvillimor Komunal, i miratuar me Vendimin nr.01nr.031-156871, dt.27.08.2013.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues "Prishtina e Re - Lindje", i miratuar me Vendimin nr.01-350/05-159745/19, dt.08.07.2019.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarëve të parcelave kadastrale që do të këmbëhet.

- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

### Arsyetim

Përgjigjja nga Ministria e Ekonomise dhe Ambientit, nr.2678-2/20, dt.22.12.2020, ka dhënë Pëlqimin për këmbimin e pjesës së parcelës kadastrale nr. 466-1, me sip.57349m<sup>2</sup>, Z.K Prishtinë në pronësi të P.Sh K.K.Prishtina, 459-0, me sip.4865m<sup>2</sup>, në pronësi të PSH, KK Prishtina dhe 616-0, me sip.4318m<sup>2</sup> në pronësi të PSH, rrugë publike e pakategorizuar, me destinim për ndërtim dhe një pjesë e destinuar për shkollë, kopsht dhe gjelbërim, sipas Planit rregullues “Prishtina e Re - Lindje”, i miratuar me vendimin nr. 01-350/05-159745/19, dt. 08.07.2019, dhe pjesët e parcelave me nr. 603-2, sip.7310m<sup>2</sup>, 603-3, sip.5720m<sup>2</sup>, 603-4, sip.5223m<sup>2</sup>, 603-5, sip.5222m<sup>2</sup>, 603-6, sip.5222m<sup>2</sup>, 574-2, sip.14240m<sup>2</sup>, 578-2, sip.50914m<sup>2</sup>, 578-4, sip.3426m<sup>2</sup>, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të Rahman Haradinit dhe 574-3, sip.32640m<sup>2</sup>, në pronësi të Rahman Haradinit dhe Shaban Konxhelit, me destinim gjelbërim.

Propozimi për inicimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues “Prishtina e Re - Lindje”, i miratuar me vendimin nr. 01-350/05-159745/19, dt.08.07.2019, dhe Përgjegjja nga Ministria e Ekonomise dhe Ambientit. Pjesa e Parcelës me nr. 603-2, sip.7310m<sup>2</sup>, 603-3, sip.5720m<sup>2</sup>, 603-4, sip.5223m<sup>2</sup>, 603-5, sip.5222m<sup>2</sup>, 603-6, sip.5222m<sup>2</sup>, 574-2, sip.14240m<sup>2</sup>, 578-2, sip.50914m<sup>2</sup>, 578-4, sip.3426m<sup>2</sup>, shtrihen në gjelbërim të planifikuar.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-463/03-112375/21, më 16.06.2021

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Agim Kuleta

